

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Gas & Oil Trading-LH" SH.P.K

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *i ndryshuar* dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", *i ndryshuar*, sot më datë 23.11.2022, Ortaku i Vetëm:

- **Z. Leonard Hoxha**, shtetas romun, lindur më 14.08.1969, në Shqipëri, banues në Bukuresht, mbajtës i Pasaportës Romune lëshuar nga Autoriteti Bukuresht me Nr. 059653778 dhe me Nr. Personal: 1690814400032, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut zotërues të 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"Gas & Oil Trading-LH" sh.p.k.**, në vijim referuar si **"Shoqëria"**.

NENI 2

BAZA LIGJORE

- 2.1 *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *i ndryshuar*, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" *i ndryshuar* dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2 Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3

SELIA

- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.



- 3.2 Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 4 OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Shpërndarje, furnizim, transportim dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport të gazit natyror dhe naftës dhe/apo nënprodukteve të tyre, brenda dhe jashtë vendit, si dhe operimit në hapësirat e depozitimit të tyre. Ndërtimi dhe montimi i të gjitha paisjeve dhe mjeteve të kërkuara për linjat dhe depozitat e gazit natyror. Çdo aktivitet tjetër të dobishëm ose të nevojshëm për arritjen e objektit të saj ose që ka lidhje me të në kuptimin më të gjerë të fjalës.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- 6.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

- **Z. Leonard Hoxha**, shtetas romun, lindur më 14.08.1969, në Shqipëri, banues në Bukuresht, mbajtës i Pasaportës Romune lëshuar nga Autoriteti Bukuresht me Nr. 059653778 dhe me Nr. Personal: 1690814400032, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR



- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, *i ndryshuar*.

NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1 Emërohet si Administrator i Shoqërisë **Z. Leonard Hoxha**, shtetas romun, lindur më 14.08.1969, në Shqipëri, banues në Bukuresht, mbajtës i Pasaportës Romune lëshuar nga Autoriteti Bukuresht me Nr. 059653778 dhe me Nr. Personal: 1690814400032, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, *i ndryshuar* dhe dispozitave të Statutit të shoqërisë.
- 8.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe ka të drejtë t’i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4 Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Z.LEONARD HOXHA

